

1 E mërkurë, 18 maj 2022

2 [Aktgjykim]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 10.00

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes.

7 Mirë se keni ardhur, të gjithë.

8 Zonja Sekretare, thirrni çështjen ju lutem.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar.

10 Është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër

11 Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Ju lutem prezantohuni palët.

14 Znj. Prokurore.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar. I

16 pranishëm për Prokurorenë është Jack Smith, Prokuror i

17 Specializuar; Matthew Halling, Prokuror; Line Pederson,

18 Menaxherja e Çështjes dhe e Provave; dhe Valeria Bolici,

19 Prokurore.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Rees.

22 Z. REES: [Përkthim] Unë përfaqësoj z. Gucati. Ndihmohem

23 nga z. Bowden, z. Stephenson dhe Halilaj.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Z. Cadman.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë përfaqësoj z.
2 Haradinaj. Ndhimohem nga z. Soliman, z. Berisha.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zyra
4 Administrative.

5 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Faleminderit. Fidelma Donlon,
6 Administratore, bashkë me Jonas Nilsson dhe Kryetarin e
7 Menaxhimit të Çështjeve.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Sot Trupi Gjykses II do të shpallë vendimin në çështjen
10 gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe
11 Nasim Haradinaj. Ky dëmin shpallet në prani të akuzuarve në
12 emër të popullit të Kosovës.

13 Do të lexoj një përmbledhje të konstatimeve kryesore të
14 Trupit Gjykses. Kjo përmbledhje nuk është pjesë aktgjykimi dhe
15 nuk është autoritare. Aktgjykimi në formë të shkruar është i
16 vetmi version autoritar i konstatimeve të Trupit Gjykses.
17 Palëve do t'u jepen kopje konfidenciale të aktgjykimit pas
18 kësaj seance publike. Dhe do të vihet në dispozicion një
19 version i redaktuar pas kësaj seance.

20 Kjo çështje ka të bëjë me veprimet dhe sjelljen e të
21 akuzuarve Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinaj nga 7 dhe 25
22 shtator 2020.

23 Kjo çështje është e rëndësishme sepse pasqyron vetë
24 arsyen pse u krijuan Dhomat e Specializuara. Kjo çështje ka të
25 bëjë me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe

1 sigurinë e proceseve gjyqësore dhe çka është më e rëndësishme,
2 sigurinë, mirëqenien dhe çlirimin nga frika të qindra
3 personave të cilët janë paraqitur për të përmbushur detyrën e
4 tyre si qytetarë, si dëshmitarë. Mbrojta e tyre nga frikësimi
5 dhe dëmtimi qëndron në themelin e çdo sistemi të drejtësisë
6 penale, qoftë ai vendor apo ndërkombëtar. Pa dëshmitarë, nuk
7 mund të ketë drejtësi për viktimat apo për shoqërinë në
8 përgjithësi. Veprimet dhe sjelljet e të akuzuarve sfiduan
9 pikërisht këtë themel.

10 Tani do të flas për ngjarjet në shqyrtim.

11 Faktet e kësaj çështjeje gjyqësore mund të përmbliidhen si
12 më poshtë.

13 Gjatë tre ditëve - 7 shtator, 16 shtator dhe 22 shtator
14 2020 - persona të panjohur dorëzuan tri grupe dokumentesh, që
15 përmenden si Tre Grupet, në mjediset e Organizatës së
16 Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, OVL
17 UÇK, në Prishtinë.

18 Dokumentet kanë lidhje me punën dhe hetimet e Task Forcës
19 Hetimore Speciale, e njohur me inicialet TFHS dhe Zyrën e
20 Prokurorit të Specializuar, të njohur me inicialet ZPS. Pas
21 çdo dorëzimi të dokument, të akuzuarit thirrën dhe organizuan
22 konferenca për shtyp në të cilën ata diskutuan dhe u vunë në
23 dispozicion gazetarëve, materialin që ju ishte dorëzuar.
24 Gjithashtu, të akuzuarit morën pjesë së bashku, vetëm, ose në
25 prani të të tjerëve edhe në më shumë se 20 intervista në

1 media, në të cilat diskutuan, lexuan dhe përshkruan
2 përmbajtjen e Tre Grupeve të dokumenteve. Gjithashtu ata
3 ripublikuan artikuj në media sociale në lidhje me Tre Grupet e
4 dokumenteve. Dhe bënë komente nënçmuese dhe fyese për
5 dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm emrat e të cilëve ishin
6 në ato dokumente.

7 Gjykatësi i Vetëm i Dhomave të Specializuara lëshoi
8 urdhra në përpjekje për të ndaluar shumëfishim dhe
9 shpërndarjen e dokumenteve. Përkundër këtyre urdhrave, të
10 akuzuarit vazhduan t'u vinin në dispozicion gazetarëve
11 informacionin që përmbanin Tre Grupet e dokumenteve.

12 Gjatë gjyqimit, të akuzuarit nuk kundërshtuan faktin se
13 kishin marrë pjesë në tre konferencat për shtyp dhe në
14 paraqitjen në media në lidhje me to. Ata nuk kundërshtuan as
15 faktin se kishin pasë në zotërim Tre Grupet e Dokumenteve dhe
16 se u kishin vënë në dispozicion mediave shumë nga
17 informacionet që përmbanin ato grupe dokumentesh. Përkundrazi,
18 ata pretenduan se kishin vepruar të nisur nga shqetësimi për
19 interesin publik dhe ishin shtytur nga ZPS-ja për të ndërmarre
20 veprimet e tyre.

21 Tani do të flasë për akuzat.

22 Si rezultat, Prokurori i Specializuar ngriti gjashtë
23 akuza kundër të akuzuarve për shkelje të Kodit Penal të
24 Kosovë, KPK.

25 Pikat 1 dhe 2, pengimi i personave zyrtar në kryerjen e

1 detyrave zyrtare sipas nenit 401 të KPK-së.

2 Pika 3, frikësim gjatë procedurës penale sipas nenit 387
3 të KPK-së.

4 Pika 4, hakmarrje sipas nenit 388 të KPK-së.

5 Dhe, Pikat 5 dhe 6, shkelje e fshehtësisë së procedurës
6 sipas nenit 392 të KPK-së.

7 Sipas Prokurorit të Specializuar, të akuzuarit ishin
8 penalisht përgjegjës për vepra penale përmes kryerjes vetëm
9 dhe/ose në bashkëkryerje, tentativës për kryerje, marrëveshjes
10 për kryerje, ndihmës dhe nxitjes.

11 Dispozitat ligjore të zbatueshme për këto vepra penale
12 dhe format e përgjegjësisë penale paraqiten me hollësi në
13 aktgjykim.

14 Tani do të kaloj tek konstatimet e Trupit Gjykses në
15 lidhje me Tre Grupet e paketat përkatëse të dokumenteve.

16 Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja në tri raste
17 sekuestroi nga OVL UÇK-ja atë çka kishte mbetur nga Tre Grupet
18 e dokumenteve, të cilat korrespondojnë me ato që ZPS-ja i
19 përshkruan si Paketat 1, 2 dhe 3. ZPS-së ju dorëzua nga një
20 organ i medias edhe një grup i katërt dokumentesh, që ishte
21 marrë nga një gazetar gjatë konferencës së parë për shtyp. Ky
22 grup dokument i korrespondon Paketës 4.

23 Paketat përmbanin një sërë informacionesh të ndjeshme,
24 ndër të cilat kërkesa për ndihmë që TFHS-ja u kishte drejtuar
25 autoriteteve kompetente serbe, kërkesat e TFHS-së, të cilat

1 përmbanin emrat dhe të dhënat personale të qindra
2 dëshmitarëve; përgjigje të Prokurorisë Serbe të Krimeve të
3 Luftës ndaj kërkesave të TFHS-së që përmenden si përgjigjet e
4 PSKL-së; dhe një produkt i materialit të brendshëm të punës së
5 ZPS-së ku analizoheshin provat dhe aspektet ligjore të
6 ndërlidhura me to në lidhje me pesë persona të dyshuar nga
7 ZPS-ja i cili gjithashtu përmbante emrat e 150 dëshmitarëve
8 dhe dëshmitarëve të mundshëm.

9 Trupi Gjykses është i bindur se materiali në fjalë ishte
10 autentik dhe u përkiste dokumenteve të hetimeve të TFHS-së ose
11 ZPS-së. Trupi Gjykses është bindur se materiali ishte trajtuar
12 si konfidencial nga TFHS-ja dhe ZPS-ja.

13 Tani do të flas për konstatimet e Trupit Gjykses në
14 lidhje me akuzat.

15 Tani Trupi Gjykses do të bëjë një përmbledhje të
16 konstatimeve të veta lidhur me akuzat.

17 Fillimisht Trupi Gjykses do të trajtojë nëse të akuzuarit
18 janë fajtorë për shkeljen e fshehtësisë së procedurës në Pikat
19 5 dhe 6, më tej akuzat për frikësim dhe hakmarrje në Pikat 3
20 dhe 4 dhe, në fund, akuzat për pengim të personave zyrtarë në
21 kryerjen e detyrave zyrtare në Pikat 1 dhe 2.

22 Tani po kaloj tek Pika 5, e cila ka të bëjë me veprën
23 penale të përcaktuar në nenin 392(1) të KPK-së. Është fjala
24 për veprën penale të zbulimit të paautorizuar të çfarëdo
25 "informatash të nxjerra nga një procedurë zyrtare që sipas

1 ligjit nuk mund të zbulohen apo që janë shpallur si fshehtësi
2 me vendim të Gjykatës apo të autoritetit kompetent”.

3 Trupi Gjykses është i bindur se në kuptim të nenit 391(1)
4 të KPK-së, TFHS-ja, ZPS-ja janë autoritete kompetente për t'i
5 shpallur të dhënat e tyre të fshehta. Trupi Gjykses gjithashtu
6 është i bindur se kërkesat e TFHS-së dhe përgjigjet e PSKL-së
7 në Paketat 1, 2 dhe 4 dhe dokumentet e Paketës 3, përmbushin
8 kriteret si informacion që është shpallur i fshehtë nga një
9 autoritet kompetent.

10 I njëjti material, në bazë të nenit 62 të ligjit,
11 përmbush kriteret si informacion që sipas ligjit nuk duhet të
12 zbulohet.

13 Unë do t'u referohem këtyre dokumenteve si "informacion i
14 mbrojtur”.

15 Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit zbuluan
16 informacionin e mbrojtur në kuptim të nenit 391 [sipas
17 përkthimit], paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës: Duke
18 ekspozuar dokumentet dhe duke lejuar të pranishmit në tre
19 konferencat për shtyp t'i këqyrnin ato; duke ua treguar
20 dokumentet gazetarëve; duke ftuar ose lejuar ata që kishin
21 kamera të filmonin apo të fotografonin dokumentet; duke ftuar
22 apo lejuar të pranishmit të merrnin dokumente me vete; dhe
23 duke paraqitur, përshkruar dhe duke iu referuar përmbajtjes së
24 dokumenteve gjatë tri konferencave për shtyp dhe paraqitjeve
25 të tjera në media. Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se në

1 kontekstin e kësaj vepre penale, gazetarët janë pjesëtarë të
2 publikut.

3 Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit vepruan me
4 synim të drejtpërdrejtë për zbulimin e informacionit të
5 mbrojtur. Kjo duket veçanërisht, nga veprimet e tyre; zotimet
6 e tyre për të vijuar me publikimin e çdo dokumenti të marrë,
7 duke deklaruar se ishte detyrë e tyre ta bënin këtë;
8 inkurajimi i tyre i përsëritur për gazetarët që të publikonin
9 dokumentet; dhe deklaratat e tyre se mirëprisnin dorëzime të
10 tjera të dokumenteve të tilla.

11 Rrjedhimisht Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka
12 vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm veprën penale të Pikës
13 5 në lidhje me dy të akuzuarit.

14 Pika 6 ka të bëjë me formën bazë dhe të rëndë të veprës
15 penale. Forma bazë ka të bëjë me veprën penale të zbulimit të
16 informacionit për identitetin apo të dhënave personale të
17 personit të mbrojtur në procedurë penale apo në një program të
18 veçantë të mbrojtur sipas nenit 392(2) të KPK-së.

19 Forma e rëndë sipas nenit 392(3) të KPK-së zbatohet në
20 rastet kur zbulimi i identitetit të personave të mbrojtur
21 shkakton pasoja të rënda ose kur procedura penale pamundësohet
22 apo pengohet shumë.

23 Trupi Gjykses është bindur se dëshmitarët dhe dëshmitarët
24 e mundshëm, emrat dhe të dhënat personale të të cilëve
25 përmendeshin në informacionin e mbrojtur, përmbushnin kriteret

1 si "persona të mbrojtur në procedurë penale" në kuptim të
2 nenit 392(2) të KPK-së. Trupi Gjykses thekson se TFHS-ja dhe
3 ZPS-ja në kuadër të hetimeve të tyre nuk i bënë publike emrat e
4 këtyre dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm.

5 Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit zbuluan
6 identitete dhe/ose të dhënat personale të dëshmitarëve dhe
7 dëshmitarëve të mundshëm të marrë në mbrojtje nga TFHS-ja/ZPS-
8 ja në njëjtën mënyrë siç zbuluan informacionin e mbrojtur.
9 Gjithashtu, të akuzuarit përmendën se në Tre Grupet me
10 dokumente ishin emra, vendbanime të mëparshme dhe aktuale,
11 numra telefonash, përkatësi etnike, vendet ku ishin zhvilluar
12 intervistat dhe përmbajtjet e deklaratave të dëshmitarëve. Ata
13 gjithashtu ftuan gazetarë që të njiheshin me këtë informacion.
14 Gjithashtu, z. Haradinaj përmendi emrat e së paku pesë
15 dëshmitarëve apo dëshmitarëve të mundshëm.

16 Trupi Gjykses është gjithashtu i bindur se të akuzuarit
17 vepruan me synim të drejtpërdrejtë në zbulimin e emrave dhe të
18 dhënave personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të
19 mundshëm.

20 Veprat e të akuzuarve shkaktuan "pasoja të rënda" në
21 kuptim të nenit 392, paragrafi 3, të KPK-së për dy dëshmitarë
22 të cilët u zhvendosën, për dëshmitarë të cilët u bënë objekt i
23 planifikimit urgjent të menaxhimit të riskut dhe për së paku
24 një person i cili u përmend publikisht me emër si dëshmitar.
25 Të dy të akuzuarit ishin të vetëdijsëm se si rezultat i

1 veprimeve të tyre mund të shkaktoheshin pasoja të tilla dhe
2 ata u pajtuan me shkaktimin e tyre.

3 Sidoqoftë, Trupi Gjykses, nuk është bindur se veprimet e
4 të akuzuarve pamundësuan, apo penguan shumë, hetimet e ZPS-së.

5 Rrjedhimisht Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka
6 vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm formën bazë të veprës
7 penale në Pikën 6 dhe formën e rëndë vetëm sa u përket
8 "pasojave të rënda", në lidhje me dy të akuzuarit.

9 Tani do të kaloj ke Pika 3 dhe 4.

10 Pika 3 ka të bëjë me veprën penale të frikësimit. Sipas
11 nenit 387 të KPK-së, "kushdo që përdor forcën apo kanosjen
12 serioze apo ndonjë mënyrë tjetër të detyrimit, premtim dhurate
13 apo ndonjë përfitim tjetër për të nxitur personin tjetër të
14 përmbahet nga dhënia e deklaratës apo për të dhënë deklaratë
15 të rreme apo për të mos dhënë informacione të vërteta
16 policisë, prokurorit apo gjyqtarit, kur informacione të tilla
17 ndërlidhen me pengimin e procedurës penale" është fajtor për
18 këtë vepër penale.

19 Trupi Gjykses ka konstatuar se të akuzuarit zbuluan
20 identitete dhe/ose të dhënat personale të qindra dëshmitarëve
21 dhe dëshmitarëve të mundshëm të përmendur në informacionin e
22 mbrojtur. Gjithashtu në paraqitjet publike, të akuzuarit
23 tërhoqën vëmendjen për numrin e madh të dëshmitarëve që ata
24 kishin identifikuar në dokumente dhe e theksuan publikisht dhe
25 në mënyrë të përsëritur, praninë e emrave të tyre në to.

1 Përafërsisht 70, 80 për qind e materialeve të Tre Grupeve
2 të dokumenteve u shpërndanë pa u përzgjedhur dhe pa asnjë masë
3 mbrojtëse paraprake të mirëfilltë. Qëllimi ishte të tërhiqej
4 vëmendja e publikut të gjerë. Të akuzuarit nuk i kushtuan
5 rëndësi faktit se ku dhe në duart e kujt do të përfundonte
6 informacioni që ata zbuluan.

7 Për më tepër, të akuzuarit deklaruan shprehimisht se
8 tashmë dihej nga publiku, përfshirë edhe nga dëshmitarë, se të
9 tjerët e dinin se kush ishin ata. Të akuzuarit bënë deklaratë
10 të përsëritura se kjo Gjykatë nuk ishte në gjendje të
11 garantonte privatësinë dhe sigurinë e dëshmitarëve të saj,
12 duke theksuar kështu më tej cenueshmërinë e tyre. Të akuzuarit
13 përdorën platformën e përbashkët të OVL UÇK-së dhe funksionet
14 e tyre zyrtare brenda kësaj organizate për të kryer veprimet e
15 tyre.

16 Gjithashtu, të akuzuarit vunë publikisht në dyshim
17 vërtetësinë e informacionit të dhënë nga dëshmitarët, duke i
18 quajtur ata, citoj, "gënjeshtarë" dhe duke pretenduar pa
19 ndonjë arsye të besueshme se ata kishin dhënë dëshmi për të
20 nxjerrë përfitime apo sepse ishin detyruar. Të akuzuarit,
21 gjithashtu, ju referuan dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të
22 mundshëm me një gjuhë nënçmuese dhe kërcënuese duke i quajtur,
23 po citoj, "tradhtarë, spiunë, bashkëpunëtorë dhe shqipfolësa",
24 duke i bërë kështu jehonë një retorike të njohur e cila të
25 synonte të ngjallte armiqësi ndaj atyre që kishin zgjedhur të

1 bashkëpunonin me ZPS-në.

2 Mesazhi i të akuzuarve për këta dëshmitarë ishte tani që
3 të gjithë e dinë se kush jeni, askush nuk mund t'ju mbrojë
4 sepse jeni tradhtarë, spiunë, bashkëpunëtorë, shqipfolës që
5 nuk ja doni të mirën Kosovës, e citoj "dhe UÇK-së".

6 Këto veprime dhe deklaratat u bënë në një atmosferë të
7 frikësimit të dëshmitarëve. Trupi Gjykses është i vetëdijshëm
8 se format tinëzore të frikësimit të dëshmitarëve ju kanë hequr
9 vazhdimisht viktimave mundësinë për të thënë të vërtetën në
10 lidhje me krimet e kryera ndaj tyre dhe kanë penguar ndjeshëm
11 përpjekjet për pajtim në shoqëritë e dala nga konflikte.

12 Autoritetet në Kosovë dhe në Tribunalin e Hagës janë
13 përpjekur për vite me radhë të luftojnë atmosferën e
14 frikësimit të dëshmitarëve e cila ka pasë një ndikim të madh
15 në hetime dhe ndjekje penale të krimeve që kanë ndodhur në
16 Kosovë.

17 Të akuzuarit e dinin mirë këtë.

18 Trupi Gjykses konstaton se veprimet dhe deklaratat e të
19 akuzuarave shkaktuan kërcënim të rëndë, i cili do të kishte
20 krijuar frikë dhe shqetësime të rënda për shumë dëshmitarë apo
21 dëshmitarë të mundshëm.

22 Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur se të akuzuarit e
23 përdorën këtë kërcënim të rëndë me synimin e drejtpërdrejtë
24 për t'i frikësuar dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm dhe
25 për pasojë për t'i bërë të nguronin që të jepnin informacion

1 në hetimet lidhur me ish-anëtarët e UÇK-së.

2 Sjellja e të akuzuarve ishte mjet që shërbente për një
3 qëllim për të penguar hetimet dhe ndjekjet penale të efektshme
4 të ish-anëtarëve të UÇK-së nga ZPS-ja. Thënë thjesht, pa
5 dëshmitarë, nuk do të kishte gjykime; dhe pa gjykime, nuk do
6 të kishte dënime të atyre që nga njëri prej të akuzuarve u
7 cilësua si djemtë e Kosovës.

8 Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar përtej
9 dyshimit të arsyeshëm veprën penale në Pikën 3 në lidhje me të
10 dy të akuzuarit.

11 Pika 4 ka të bëjë me veprën penale të hakmarrjes.

12 "Kushdo që ndërmerri ndonjë veprim të dëmshëm për të
13 cilindo person, përfshirë ndërhyrjen në punësimin e ligjshëm
14 apo sigurimin e mjeteve të jetesës së ndonjë personi me qëllim
15 të hakmarrjes për shkak të dhënies së informacioneve të
16 vërteta policisë, hetuesit, prokurorit apo gjyqtarit lidhur me
17 kryerjen apo kryerjen e mundshme të veprës penale" është
18 fajtor për veprën penale sipas nenit 388, paragrafi 1 të KPK-
19 së.

20 Trupi Gjykses ka konstatuar në Pikën 3 se veprimet dhe
21 deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë.

22 I njëjti konstatim vlen dhe për Pikën 4. Veprimet dhe
23 deklaratat e të akuzuarve në kuptim të nenit 388(1) të KPK-së
24 përbënin veprime të dëmshme për cilindo person.

25 Trupi Gjykses thekson se pretendimet e të akuzuarve se

1 dëshmitë e dëshmitarëve ishin të pavërteta nuk vërtetojnë në
2 vetvete se të akuzuarit e besonin këtë gjë. Sidoqoftë, Trupi
3 Gjykses, thekson se ZPS-ja nuk paraqiti ndonjë provë për t'i
4 kundërshtuar këto deklarata. Kjo nuk vë në asnjë mënyrë në
5 pikëpyetje besueshmërinë e dëshmitarëve apo dëshmitarëve të
6 mundshëm, emrat e të cilëve përmendeshin në informacionin e
7 mbrojtur.

8 Megjithatë, sipas nenit 388(1) të KPK-së, është detyra,
9 është barra e ZPS-së të vërtetojë se të akuzuarit ishin të
10 vetëdijshtëm se informacionet e dëshmitarëve kishin, të paktën
11 deri në një farë mase, vërtetësi. ZPS-ja nuk arriti të
12 vërtetonte se të akuzuarit ishin të vetëdijshtëm për këtë.

13 Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka
14 arritur të vërtetojë se të akuzuarit vepruan me synimin e
15 nevojshëm ndaj cilitdo prej dëshmitarëve të cilët ata i
16 zbuluan identitetin dhe/ose të dhënat personale. Rrjedhimisht
17 Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë
18 përtej dyshimit të arsyeshëm veprën penale të Pikës 4 në
19 lidhje me dy të akuzuarit.

20 Tani do të kaloj tek Pikat 1 dhe 2.

21 Pika 1 ka të bëjë me veprën penale të pengimit të
22 personave zyrtarë me anë të forcës ose kërcënimit të rëndë.

23 "Kushdo, që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose
24 tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave
25 zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta, e detyron atë të

1 kryejë detyrën zyrtare" është fajtor për veprën penale sipas
2 nenit 401(1) të Kodit Penal të Kosovës. Kjo është forma bazë e
3 kësaj vepre penale.

4 Forma e rëndë zbatohet në rastet kur forma bazë kryhet
5 kundër kategorive të veçanta të personave, përfshirë kundër
6 gjyqtarit, prokurorit ose zyrtarit të Gjykatës.

7 Trupi Gjykses konstatoi në lidhje me Pikën 3 se veprimet
8 dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të rëndë.

9 I njëjti konstatim vlen edhe për Pikën 1.

10 Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstaton se në kuptimin e
11 nenit 404(1) të KPK-së, veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve
12 përbëjnë kanosje serioze.

13 Trupi Gjykses rithekson se kryerja e detyra zyrtare në
14 kuadër të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së varet në një
15 masë të madhe nga gatishmëria dhe aftësia e dëshmitarëve për
16 t'u paraqitur dhe për të dhënë lirisht dëshmitë e tyre.

17 Trupi Gjykses ka konstatuar se veprimet e të akuzuarve
18 shkaktuan pasoja të rënda për një numër dëshmitarësh ose
19 dëshmitarësh të mundshëm, por Trupit Gjykses nuk i është
20 paraqitur asnjë provë se sjellja e të akuzuarve, faktikisht,
21 bëri që ndonjë nga këto persona apo ndonjë dëshmitar tjetër të
22 mos jepte dëshmi për Dhomat e Specializuara dhe ZPS-në. ZPS-ja
23 gjithashtu nuk ka demonstruar pengesë konkrete dhe aktuale që
24 i është shkaktuar hetimeve të saj për të cilin përgjegjësia do
25 të mund të atribuojë veprimet e të të akuzuarve. Gjithashtu

1 nuk ka ndonjë të dhënë se si rezultat i devijimit të kohës dhe
2 kapaciteteve ZPS-ja është penguar apo vonuar në kryerjen e
3 funksioneve të saj të zakonshme.

4 Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja nuk ka
5 arritur të vërtetojë se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve
6 penguan zyrtarët e DHS-së dhe ZPS-së në kryerjen e detyrave të
7 tyre zyrtare.

8 Sidoqoftë, Trupi Gjykses rikujton se vepra penale sipas
9 nenit 401(1) të KPK-së mund të kryhet edhe nëse pengimi
10 tentohet por nuk çohet deri në fund. Pasi konstatoi se
11 veprimet dhe deklaratat e të akuzuarve përbënin kërcënim të
12 rëndë, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit tentuan të
13 pengonin zyrtarët e Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së në
14 kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.

15 Trupi Gjykses është i bindur se të akuzuarit këtë e bënë
16 me synim të drejtpërdrejtë. Kjo shihet qartë nga pretendimet e
17 të akuzuarve se ishte detyra e tyre të bënin të njohur
18 informacionin e mbrojtur për të nxjerrë në pah se, sipas
19 fjalëve të tyre, sa skandaloze, të turpshme dhe të
20 papranueshme ishin Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja për
21 faktin se dhe citoj "bashkëpunonin me autoritet serbe dhe me
22 dëshmitarë jo të besueshëm" dhe për faktin se nuk i mbronin
23 këto dëshmitarë.

24 Gjatë kryerjes së asaj që të akuzuarit e përshkruanin si
25 detyrë e tyre për të zbuluar në informacionin e mbrojtur, të

1 akuzuarit gjithashtu deklaruan se dështimi i Dhomave të
2 Specializuara ishte i pashmangshëm. Të dy të akuzuarit i bënë
3 të qarta synimet e tyre për të mos ju bindur urdhrave të
4 Dhomave të Specializuara dhe të ZPS-së. Gjithashtu, të dy të
5 akuzuarit deklaruan shprehimisht se ato donin të ndalnin ose
6 dëmtonin proceset e Dhomave të Specializuara, në mënyrë që ajo
7 për të cilën e përshkruan si një Gjykatë pa vlerë dhe të
8 njëanshme të mos ndiqte penalisht atë dhe që unë e citoj që
9 quheshin "djemtë e Kosovës"

10 Trupi Gjykses konstaton se veprimet dhe deklaratat e të
11 akuzuarve tregojnë qartë dëshirën për të penguar marrjen e
12 dëshmive të dëshmitarëve nga hetuesit dhe Prokurorët e ZPS-së
13 gjë që përmbush kriteret e formës së rëndë të veprës penale.

14 Rrjedhimisht Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka
15 vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm formën bazë dhe të
16 rëndë të veprës penale të Pikës 1 në lidhje me të dy të
17 akuzuarit.

18 Pika 2 ka të bëjë me veprën penale të pengimit të
19 personave zyrtarë me anë të veprimeve të përbashkëta si grup.

20 "Kushdo që merr pjesë në një grup personash që me veprim
21 të përbashkët pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në
22 kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta,
23 e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare" është fajtor për
24 veprën penale sipas nenit 401, paragrafi 2, të Kodit Penal të
25 Kosovës.

1 Pika 2 përfshin gjithashtu të njëjtën formë të rëndë si
2 në Pikën 1 dhe një formë tjetër të rëndë e cila zbatohet në
3 rast kur veprën penale e kryen udhëheqësi apo organizatori i
4 grupit.

5 Trupi Gjykses është i bindur se të akuzuarit nuk vepruan
6 të vetëm në zbulimin e informacionit të mbrojtur.

7 Provat vërtetojnë se z. Gucati, z. Haradinaj dhe z. Faton
8 Klinaku vepruan si grup, përmes ndarjes midis tyre të detyrës
9 së organizimit të tri konferencave për shtyp, paraqitjes së
10 informacionit që përmbanin Tre Grupet e dokumenteve, përmes
11 kontakteve me ZPS-në dhe përmes shprehjes së qëndrimeve të
12 përbashkëta gjatë paraqitjeve në media lidhur me zbulimin e
13 informacionit të mbrojtur dhe pengimin e Dhomave të
14 Specializuara dhe ZPS-së.

15 Siç përcaktohet në Pikën 1, të akuzuarit vepruan me
16 synimin e drejtpërdrejtë për të penguar zyrtarët e Dhomave të
17 Specializuara dhe ZPS-së në kryerjen e funksioneve të tyre.

18 Trupi Gjykses konsideron se ky konstatim vlen edhe për
19 Pikën 2 dhe konstaton se të akuzuarit vepruan në grup me
20 synimin e drejtpërdrejtë për të penguar me anë të veprimeve të
21 përbashkëta zyrtarët e Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së në
22 kryerjen e funksioneve të tyre.

23 Trupi Gjykses është i bindur se z. Gucati dhe është
24 mbrojtur nga të akuzuarit dhe z. Klinaku në përpjekje të tyre
25 për të zbuluar informacionin e mbrojtur dhe për të penguar

1 zyrtarët e Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së në kryerjen e
2 funksionit të tyre zyrtare. Për këtë arsye, Trupi Gjykses
3 është i bindur se z. Gucati veproi si udhëheqës i grupit.

4 z. Haradinaj, veproj nën autoritetin e z. Gucati dhe
5 luajti një rol të qenësishëm si anëtar i grupit. Trupi Gjykses
6 nuk është i bindur se ai veproi si udhëheqës apo organizator.

7 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka
8 vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm veprën penale sipas
9 nenit 401(2) dhe (5) në lidhje me të dy të akuzuarit.

10 Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se ZPS-ja ka vërtetuar
11 përtej dyshimit të arsyeshëm formën e rëndë të veprës penale
12 sipas nenit 401, paragrafi 3, në lidhje me z. Gucati.

13 Çështja tjetër janë format e përgjegjësisë penale.

14 Lidhur me llojin e pjesëmarrjes së të akuzuarve në këto
15 vepra penale, Trupi Gjykses konstaton se të akuzuarit morën
16 pjesë bashkërisht dhe dhanë kontribut thelbësor si bashkëkryes
17 në kryerjen e veprave penale të Pikave 1, 3, 5 dhe 6.

18 Trupi Gjykses gjithashtu konstaton se z. Gucati dhe z.
19 Haradinaj kryen individualisht veprën penale të Pikës 2.

20 Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se të
21 akuzuarit janë penalisht përgjegjës si bashkëkryes për veprat
22 penale të Pikave 1, 3, 5 dhe 6 dhe si kryes individual për
23 veprën penale të Pikës 2.

24 Tani do t'i kthehem argumenteve mbrojtëse që janë
25 argumentet e paraqitura nga të akuzuarit për të arsyetuar

1 veprimet e tyre.

2 Për sa i përket interesit publik, Trupi Gjykses konstaton
3 se nuk ka arsye të besueshme për të nxjerrë përfundimin se
4 informacioni i mbrojtur i zbuluar nga të akuzuarit përmbante
5 të dhëna për parregullsi të kryera nga TFHS-ja/ZPS-ja ose që
6 veprimet e të akuzuarve ishin të arsyetuara pasi ato
7 udhëhiqeshin nga interesi i pretenduar publik.

8 Trupi Gjykses më tej konstaton se asnjë nga të akuzuarit
9 nuk mund të konsiderohet si sinjalizues nëse veprimet e tyre
10 dalin jashtë kuadrit të mbrojtjes që u garantohet personave të
11 tillë sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe
12 legjislacionit të Kosovës, ndër të tjera dhe Kushtetutën.

13 Në lidhje me pretendimin e shtytjes për kryerje të veprës
14 penale, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtjes ju afroa në
15 mënyrë të plotë dhe të drejtë mundësia për të argumentuar këtë
16 pretendim bazuar në standardet e përcaktuara nga Gjykata
17 Evropiane e të Drejtave të Njeriut të cilëve Trupi Gjykses u
18 përmbahet plotësisht.

19 Trupi Gjykses më tej konstaton se as deklaratat e të
20 akuzuarve në atë kohë, as dëshmitë e tyre në gjykim nuk
21 ofrojnë arsye objektive për të besuar se të akuzuarit janë
22 shtytur.

23 Trupi Gjykses ka analizuar me kujdes argumentet e
24 parashtruara nga Mbrojtja e Gucatit si prova rrethore të
25 shtytjes dhe konstaton se ato nuk ofrojnë një bazë të

1 arsyeshme për të arritur në përfundimin se ka patur shtytje.

2 Trupi Gjykses konstaton se pretendimi për shtytje është
3 tërësisht i pagjasë dhe i pabazë.

4 Sa i përket lajthimit ligjor, Trupi Gjykses është i
5 bindur se gjatë periudhës që përfshinë aktakuzat, të akuzuarit
6 e dinin se sjellja e tyre ishte ligjërisht e ndaluar dhe, se
7 gjithsesi, nuk kishin arsye të justifikueshme që të mos e dini
8 se ishte ligjërisht e ndaluar.

9 Rrjedhimisht Trupi Gjykses konstaton se përgjegjësia
10 penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohet mbi bazën e
11 elementit të interesit publik, pretendimi për shtytje apo
12 argumentit mbrojtës për lajthim ligjor.

13 Trupi Gjykses gjithashtu, konstaton se përgjegjësia
14 penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohet mbi bazën e
15 argumenteve të Mbrojtjes e të nevojës ekstreme, lajthimit
16 faktik dhe veprimeve të një rëndësie të vogël.

17 I kthehem tani dënimit.

18 Të akuzuarit janë përgjegjës për vepra të rënda penale të
19 cilat rrezikojnë administrimin e duhur të drejtësisë.

20 Me gjithë lëshimin e urdhrave nga Gjykatësi i Vetëm dhe
21 ZPS-ja, të akuzuarit vazhduan të shpërndanin në shkallë të
22 gjerë informacionin e mbrojtur, që përfshinte emrat e qindra
23 dëshmitarëve të mbrojtur, përmes konferencave të organizuara
24 për shtyp dhe paraqitjet e tjera në media. Ata e bënë këtë në
25 mënyrë të përsëritur dhe me entuziazëm dhe u zotuan se do ta

1 bënin sërish.

2 Të akuzuarit i trajtuan me përbuzje dhe fyerje, ata që
3 zgjodhën të bashkëpunojnë me këtë Gjykatë në kërkim të së
4 vërtetës dhe u shprehën në një mënyrë që mund të kishte vetëm
5 synimin që t'i bindte që të mos i jepnin asnjë informacion
6 tjetër ZPS-së as të dëshmonin në ndonjë gjykim të ardhshëm.
7 Sjellja e të akuzuarve ndikoi mbi një numër të madh njerëzish
8 dhe shkaktoi frikë dhe shqetësim te disa prej tyre.

9 Të akuzuarit nuk treguan shqetësim për pasojat apo
10 pasojat e mundshme të veprimeve të tyre. Ata vepruan në mënyrë
11 flagrante, haptazi, pa bërë dallime dhe duke shpërfillur
12 sundimin e ligjit apo autoritetin e kësaj gjykate.

13 Ky aktgjykim përshkruan qartë këto veprime ashtu siç
14 janë: kriminale dhe jo patriotike, kërcënim për drejtësinë jo
15 të udhëhequra nga interesi publik.

16 Trupi Gjykses konstaton se nuk ka faktorë të tjerë
17 rëndues sa i përket kontributit të të akuzuarve në kryerjen e
18 këtyre veprave të rënda penale.

19 Trupi Gjykses konsideron si faktor lehtësues situatën
20 familjare dhe/ose shëndetësore të të dy të akuzuarve si dhe në
21 lidhje e z. Gucati, punën e tij në komunitet.

22 Kjo ishte përmbledhja dhe konstatimi i Trupit Gjykses.

23 Tani do të lexoj vendimin.

24 Z. Hysni Gucati, ju lutem ngrihuni në këmbë.

25 Në emër të popullit të Kosovës, për arsyet e shtjelluara

1 në aktgjykim dhe të përmbledhura më lart dhe duke marrë
2 parasysh të gjitha provat dhe argumentet e palëve, Trupi
3 Gjykses, në bazë neneve 43 dhe 44 të ligjit dhe rregullave
4 158, 159, 163 dhe 165 të Rregullores, ju shpall ju, z. Gucati,
5 fajtor për:

6 A, Pikën 1, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
7 detyrave zyrtare nëpërmjet kërcënimit të rëndë, sipas neneve
8 15, paragrafi 2 dhe 16, paragrafi 3 të ligjit dhe neneve 17,
9 31 dhe 401, paragrafi 1 dhe 5 të Kodit Penal të Kosovës;

10 B, Pika 2, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
11 detyrave zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në veprime të
12 përbashkët të një grupi sipas neneve 15, paragrafi 2 dhe 16
13 paragrafi 3 të ligjit dhe neneve 17 dhe 401 paragrafët 2, 3
14 dhe 5 të Kodit Penal të Kosovës;

15 C, Pika 3, frikësim gjatë procedurës penale, sipas nenit
16 15, paragrafi 2 dhe 16, paragrafi 3 të ligjit dhe neneve 17,
17 31 dhe 387 të Kodit penal të Kosovës;

18 D, Pika 5, shkelje të fshehtësisë së procedurës nëpërmjet
19 zbulimit të paautorizuar të informacioneve të fshehtë të
20 nxjerrë në procedura zyrtare sipas neneve 15, paragrafi 2 dhe
21 16, paragrafi 3 të ligjit dhe neneve 17, 31 dhe 392, paragrafi
22 1 të kodit Penal të Kosovës; dhe

23 E, Pika 6, shkelje të fshehtësisë së procedurës nëpërmjet
24 zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave
25 personale të dëshmitarëve të mbrojtur sipas neneve 15,

1 paragrafi 2 dhe 16, paragrafi 3 të ligjit dhe neneve 17, 31,
2 392 paragrafi 2 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës.

3 Trupi Gjykses ju shpall të pafajshëm për Pikën 4,
4 hakmarrje.

5 Trupi Gjykses ju dënon me një dënim të njëjtësuar prej 4
6 vjet e gjysëm burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në
7 paraburgim dhe me një gjobë prej 100 eurosh e cila duhet
8 paguar deri më 18 korrik 2022.

9 Z. Gucati, mund të uleni.

10 Z. Nasim Haradinaj, ju lutem ngrihuni në këmbë.

11 Në emër të popullit të Kosovës për arsyet e shtjelluara
12 në aktgjykim dhe të përmbledhura më lartë dhe duke marrë
13 parasysh të gjitha provat dhe argumentet e palëve, Trupi
14 Gjykses, në bazë të neneve 43 dhe 44 të ligjit dhe rregullave
15 158, 159, 163 dhe 165 të Rregullores, ju shpall ju, z.

16 Haradinaj, fajtor për:

17 A, Pika 2, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
18 detyrave zyrtare nëpërmjet kërcënimit të rëndë, sipas neneve
19 15, paragrafi 2 dhe 16, paragrafi 3 të ligjit dhe neneve 17,
20 31 dhe 401 paragrafi 1 dhe 5 të Kodit Penal të Kosovës;

21 B, Pika 2, pengim të personave zyrtarë në kryerjen e
22 detyrave zyrtare nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimin e
23 përbashkët të një grupi sipas neneve 15, paragrafi 2 dhe 16,
24 paragrafi 3 të ligjit dhe neneve 17 dhe 401, paragrafi 2 dhe 5
25 të Kodit Penal të Kosovës;

1 C, Pika 3, frikësim gjatë procedurës penale sipas neneve
2 15, paragrafi 2 dhe 16, paragrafi 3 të ligjit dhe neneve 17,
3 31 dhe 387 të Kodit Penal të Kosovës;

4 D, Pika 5, shkelje të fshehtësisë së procedurës nëpërmjet
5 zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të
6 nxjerrë në procedura zyrtare sipas neneve 15, paragrafi 2 dhe
7 16, paragrafi 3 të ligjit dhe neneve 17, 31, dhe 392,
8 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës; dhe

9 E, Pika 6, Shkelje të fshehtësisë së procedurës nëpër
10 mjet zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave
11 personale të dëshmitarëve të mbrojtur sipas neneve 15,
12 paragrafi 2 dhe 16, paragrafi 3 të ligjit dhe neneve 17, 31
13 392 paragrafët 2 dhe 3 të Kodit Penal të Kosovës.

14 Trupi Gjykses ju shpall të pafajshëm për Pikën 4,
15 hakmarrje.

16 Trupi Gjykses ju dënon me një dënim të njësuar prej 4
17 vjet e gjysëm burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në
18 paraburgim dhe me një gjobë prej 100 eurosh të cilën duhet ta
19 paguani deri më 18 korrik 2022.

20 Z. Haradinaj, mund të uleni.

21 Tani Zyra Administrative do t'ju shpërndajë aktgjykimin
22 në formë elektronike dhe do t'i japë të akuzuarve kopje të
23 legalizuar të veprimeve të tyre.

24 Znj. Administratore, ju lutem shpërndani këto kopje.

25 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

1 palët kanë marrë tani kopjen elektronike të aktgjykimit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do t'i
3 jepni kopjet e certifikuar, të legalizuar të akuzuarve. Që
4 është edhe Dosja Paraprake 611.

5 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndërkohë që
6 bëhet kjo, a mund të sqarojmë një gjë të tillë, një gjë
7 përpara.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
9 çaktivizuar].

10 Z. REES: [Përkthim] Katër vjet e gjysëm dhe nga kjo do të
11 ulet pjesa e kaluar në paraburgim.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Varianti në
13 shqip do të dorëzohet pasi të jetë përgatitur.

14 Seanca mbyllet.

15 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, para se ta
16 ngriheni. Ju kërkoj ndjesë. A kemi një afat kohor për
17 variantin në shqip? Pasi do të jetë shumë e vështirë për ta
18 trajtuar këtë çështje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

20 --- Seanca mbyllet në orën 10.49

21

22

23

24

25